



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2021:228044  
Datë: 04.10.2022  
Numri i dokumentit: 03488102

**C.nr.1009/2021**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**, e përbërë nga gjykatësi **Betim Behluli**, në çështjen juridike të paditësit E. K. nga Rahoveci të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar avokate T. Zh. nga Prishtina, kundër të paditurës S. T. nga Prishtina, për shkak të zgjidhjes së martesës me shkurorëzim, më **04.10.2022**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Padia e paditësit E. K. nga Rahoveci të cilin përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar avokate T. Zh. nga Prishtina e ushtruar kundër të paditurës S. T. nga Prishtina, **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

Lënda si e kryer t'i deponohet arkivit të gjykatës.

**A r s y e t i m**

Paditësi E. K. nga Rahoveci të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar avokate T. Zh. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padinë, kundër të paditurës S. T. nga Prishtina, për shkak të zgjidhjes së martesës me shkurorëzim.

Paditësi E. K. nga Rahoveci të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar avokate T. Zh. nga Prishtina ku me parashtrësë të veçantë të datës 03.10.2022, e ka njoftuar gjykatën se padinë ndaj të paditurës S. T. nga Prishtina, e tërheq padinë për shkak se paditësi për të njëjtën çështje ka inicuar procedurën për zgjidhje të martesës edhe pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë ku edhe ka filluar procedura gjyqësore.

Prandaj kjo gjykatë, në bazë të nenit 261.1 të LPK - së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konstatuar se në këtë çështje kontestimore është tërheqë padia e ushtruar.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC,**  
**C.nr.1009/2021 më, 04.10.2022**

**G J Y K A T Ë S I**  
**Betim Behluli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate për gjykatën e Apelit, në Prishtinë – divizionit civil.